



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Drejtoria e Inspeksionit
Drenas, më 03.04.2019



RAPORT PËR MUAJIN MARS 2019

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar inspektime operatorëve ilegal të transportit të udhëtarëve si dhe inspektime në sektorin e ndërtimit rreth parandalimit të ndërtimeve pa leje.

SEKTORI I SANITARISË :

Gjatë muajit Mars kryesisht janë zhvilluar procedura inspektuese ndaj subjekteve hoteliere për respektim të ligjit të duhanit si dhe furrat, ordinancat dhe subjektet tjera rreth kushteve sanitare. Gjithashtu janë dhënë pëlqime ndaj ordinancave dhe barnatoreve. Është mbajtur nën mbikqyrje tregu i kafshëve dhe pemëve duke mos lejuar zhvillim aktiviteteve pa i plotsuar kushtet minimale sanitare.

SEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë këtij muaji janë mbajtur në kontroll dhe janë zhvilluar procedura për ndërtimet në objektet banesore në Drenas të cilat janë duke u shëndrruar në objekte afariste duke i mbajtur nën vëzhgim në bazë të procedurave. Janë realizuar procedura të kthimit të pronave komunës të cilat janë të uzurpuara. Janë mbikqyrë ndërtimet e reja pa leje ndërtimore ndaj të cilave janë zhvilluar procedurat ligjore. Kompania e rrënimt nuk është në dispozicion për shkak të procedurave të prokurimit, pritet gjatë muajit tjetër të lidhet kontratë në mënyrë që të vazhdojmë me procedurat e ekzekutimeve të aktvendimeve për rrënim.

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Në zbatim të Planit Operativ, kanë bërë inspektime rreth transportit të udhëtarëve me rëndësi të veçantë, kontrollë e operatorëve ilegal si dhe rendin e udhëtimit të operatorëve legal, ku gjatë këtij muaji është realizuar plani operativ me Policinë e Kosovës rreth operimit të transportit ilegal.

SEKTORI I TREGUT

Gjatë këtij muaji është angazhuar për përcjelljen e bizneseve tek zyra e regjistrimit të bizneseve në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik për të gjitha bizneset që nuk kanë kryer obligimet financiare si dhe bizneset e pa regjistruara.

SEKTORI I AMBIENTIT

Janë zhvilluar inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palëve, me fokus në inspektimin e bizneseve në relacionin Drenas-Komoran rreth hyrjes së tyre në sistem të menaxhimit të mbeturinave ku gjatë këtij muaji janë urdhëruar që të hyjnë në sistem të menaxhimit të mbeturinave biznese të reja.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin Mars 2019:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjoha mandatore	Fletë paraqitje për gjykatë	Kërkesa për Pëlqime Sanitare/Tregut /Mjedisore	Pëlqime Sanitare/ për Ushtrim të Veprimtarisë	Kërkesa	Shqyrtim i kerkesave	Mbyllje e lokaleve	Konfiskim i automjeteve
Sanitari	6	3	1	0	3	3	0	3	N/A	0
Treg	4	0	0	0	11	2	0	0	6	N/A
Komunikacion	20	0	2	0	N/A	N/A	2	2	N/A	12
Ndërtim	45	9	3	0	NA	N/A	8	8	N/A	N/A
Ambient	27	0	3	0	4	0	3	3	N/A	N/A
Totali	102	12	9	0	18	5	13	16	6	12

Prill, 2019

Drejtoreshë e Drejtorisë

Aurora Berisha